

UDHËZIM
Nr. 20, datë 1.6.2020

**PËR ELEMENTET BAZË DHE TEKNIKE, LËSHIMIN DHE SHKËMBIMIN E
FATURAVE ELEKTRONIKE DHE FATURAVE SHOQËRUESE**

Në mbështetje të nenit 102, paragrafi 4, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të neneve 28 dhe 40, të ligjit nr. 87/2019, datë 18.12.2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, udhëzoj:

KREU I
DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1

Qëllimi i udhëzimit

Ky udhëzim përcakton elementet bazë dhe teknike të një fature elektronike dhe fature shoqëruese, lëshuesit dhe marrësit e faturave elektronike dhe faturave shoqëruese, procedurën e lëshimit dhe shkëmbimit të faturave elektronike dhe dokumenteve shoqëruese, marrjen dhe dërgimin e mesazheve për faturat elektronike në pamundësi të lëshimit dhe shkëmbimit të faturës elektronike për transaksione pa para në dorë dhe për transaksione me organet publike, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 87/2019, datë 18.12.2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit” (më tej referuar si “Ligji”).

Neni 2

Fatura elektronike

1. Fatura elektronike duhet të jetë në përputhje me Standardet Shqiptare (SSH) dhe Dokumentat Shqiptare të Standardizimit (DS) në fuqi (përfshirë këtu korrigjimet, ndryshimet dhe amendimet e tyre), të publikuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit e Shqipërisë (DPS) dhe të cilat janë adoptime të standardeve evropiane (EN) dhe specifikimeve teknike (TS), të publikuara nga Komiteti Evropian për Standardizimin (CEN). Për referencë është standardi SSH EN 16931-1 “Faturimi elektronik – pjesa 1: Modeli semantik i të dhënave të elementeve thelbësore të një fature elektronike”.

2. Lëshuesi i faturës elektronike duhet të sigurojë që të dhënat e vendosura në faturën elektronike pasqyrojnë furnizimin real.

3. Lëshuesi dhe marrësi i faturës elektronike duhet të sigurojnë autenticitetin e origjinës, integritetin e përmbajtjes dhe lexueshmërinë e faturave elektronike nga momenti i lëshimit deri në fund të periudhës së ruajtjes së faturës elektronike.

Neni 3

Përkufizime

Termet e mëposhtëm të përdorur në këtë udhëzim kanë këto kuptime:

a) “Standardi Evropian” (në vijim: Standardi Evropian) - standard i vendosur nga Komiteti Evropian për Standardizim (CEN) më 28.6.2017, EN 16931-1: 2017, fatura elektronike – pjesa 1: Modeli semantik i të dhënave të elementeve thelbësore të një fature elektronike dhe listës së sintaksave DS CEN / TS 16931-2 “Fatura elektronike – pjesa 2: lista e sintaksave që përputhen me EN 16931-1”;

b) “Faturë elektronike” – sipas kuptimit të përcaktuar në ligj;

c) “Dokument shoqërues” – dokument biznesi, bën pjesë në strukturën e faturës elektronike dhe është lëshuar e shkëmbyer së bashku me faturën elektronike;

d) “Platforma qendrore e faturave” – është një segment i zgjidhjes së TI-së e zhvilluar nga AKSHI për qëllimet e faturimit dhe procedurës së fiskalizimit, shkëmbimin e faturave elektronike, lidhjen dhe regjistrimin e lëshuesve dhe marrësve të faturave elektronike dhe për administrimin unik të procesit të shkëmbimit të faturave elektronike dhe dokumenteve shoqëruese;

e) “Shërbimi i web-it SOAP” – protokoll i bazuar në XML që ka për qëllim shkëmbimin e informacionit të strukturuar ndërmjet tatimpaguesit dhe administratës tatimore nëpërmjet sistemeve kompjuterike;

f) “Aplikacioni i portalit” – ndërfaqja e standartizuar për komunikim ndërmjet tatimpaguesit dhe administratës tatimore nëpërmjet rrjetit të sigurt për transferimin elektronik të të dhënave nëpërmjet internetit (*Portali Self-Care*);

g) “Mesazh Extended Language Markup (XLM)” (në vijim “mesazh”) – një mesazh i standardizuar, i strukturuar që përmban të gjitha elementet e një fature elektronike dhe dokumenteve shoqëruese dhe/ose të dhëna të tjera të shkëmbyera brenda platformës qendrore të faturave;

h) “Lëshues i faturës elektronike” – sipas kuptimit të përcaktuar në ligj;

i) “Marrës i faturës elektronike” – sipas kuptimit të përcaktuar në ligj;

j) “Specifikim” – nënkupton “Specifikimin për përdorim bazë të faturës elektronike ISO / IEC 19845: 2015 (UBL 2.1)” dhe “Specifikimet për përdorimin bazë të faturave elektronike UN / CEFAC Fatura Ndëriindustriale (skemat XML 16B)”, të cilat janë specifikime teknike, në aneksin e publikuar nga institucioni përgjegjës për standartizimin, gjithashtu edhe në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

KREU II

ELEMENTET BAZË DHE TEKNIKË TË FATURËS ELEKTRONIKE

Neni 4

Elementet bazë të faturës elektronike

1. Fatura elektronike duhet të përmbajë elementët bazë të mëposhtëm:

a) titullin “Faturë tatimore” specifikohet me kodin e llojit të faturës (në specifikimet e dhëna BT-3);

b) datën (në specifikimet e dhëna BT-2) dhe kohën e lëshimit të faturës (orë, minuta dhe sekonda) (në specifikimet e dhëna BG-1);

c) numrin e faturës (në specifikimet e dhëna BT-1);

d) numrin unik të identifikimit të shitësit (në specifikimet e dhëna BT-29);

e) emrin e tatimpaguesit/emrin dhe mbiemrin e shitësit (në specifikimet e dhëna BT-27);

f) adresën e shitësit (në specifikimet e dhëna BG-5);

g) numrin unik të identifikimit, emrin e tatimpaguesit/emrin, mbiemrin dhe adresën e blerësit. Ky informacion kërkohet vetëm nëse blerësi është:

i. tatimpagues, subjekt i tatimit mbi fitimin, i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, ose subjekt i TVSH-së, në përputhje me ligjet përkatëse;

ii. një person juridik;

iii. një person që blen pasuri personale me vlerë individuale mbi 500,000 lekë;

iv. ose në raste të tjera, kur blerësi kërkon që në faturë të vendosen të dhënat e tij identifikuese (në specifikimet të dhënat BT-46, BT-44 dhe BG-8);

h) kodin e operatorit sipas nenit 3, pika “g”, të ligjit, i dhënë në përputhje me nenin 15, të ligjit (në specifikimet e dhëna BG-1);

i) kodin e vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit sipas nenit 3, pika “II”, të ligjit, i dhënë në përputhje me nenin 14 të ligjit (në specifikimet e dhëna BG-1);

j) sasinë dhe përshkrimin e mallrave të shitura, dhe përshkrimin e shërbimeve të kryera, çmimin për njësi, pra identifikuesit e artikujve të faturës, kodin e njësisë matëse të shumave të llogaritura (në specifikimet të dhënat BT-126, BT-129, BT-130, BT-146 dhe BT-153);

k) shumën e plotë (në specifikimet të dhënat BT-106 and BT-131);

l) shumën totale për t’u paguar (në specifikimet e dhëna BG-22);

m) monedhën dhe kursin e këmbimit nëse shumat në faturë nuk shprehen në monedhën kombëtare shqiptare (lekë) (në specifikimet të dhënat BT-5 dhe BG-1);

n) udhëzimin e pagesës/mënyrën e pagesës (kartëmonedha dhe monedha, karta, çek, transaksion bankar, mandat pagese, para elektronike, pagesa të tjera pa para në dorë) (në specifikimet e dhëna BG-16);

o) Numrin Identifikues të Veçantë të Faturës (NIVF), i shprehur si një shenjë alfanumerike (në specifikimet e dhëna BG-1);

p) Numrin e Sigurisë të Lëshuesit të Faturës (NSLF), i shprehur si një shenjë alfanumerike (në specifikimet e dhëna BG-1);

q) etiketën e procesit (në specifikimet e dhëna BT-23);

r) specifikimet e identifikuesit (në specifikimet e dhëna BT-24);

s) adresën e postës elektronike të shitësit (në specifikimet e dhëna BT-34);

t) adresën e postës elektronike të blerësit (në specifikimet e dhëna BT-49).

2. Elemente shtesë për faturat me TVSH:

a) detajet e çmimit, siç janë çmimi për njësi pa TVSH, zbritjet mbi çmimin (në specifikimet e dhëna BG-29);

b) shuma bazë e kategorisë së TVSH-së (në specifikimet e dhëna BT-116);

c) shuma e kategorisë së TVSH-së (në specifikimet e dhëna BT-117);

d) kodi i kategorisë së TVSH-së (në specifikimet e dhëna BT-118);

e) kategoria e normës së TVSH-së (në specifikimet e dhëna BT-119);

f) shuma totale e TVSH-së së faturës (në specifikimet e dhëna BT-110);

g) shuma totale e faturës me TVSH (në specifikimet e dhëna BT-112);

h) arsyeja e përjashtimit nga TVSH-ja (në specifikimet të dhënat BT-120 dhe BT-121);

i) kur fatura lëshohet për pagesa të bëra paraprakisht dhe TVSH llogaritet në momentin e marrjes së pagesës dhe e drejta e zbritjes lind në këtë moment, fatura duhet të përmbajë tekstin: “Parapagesë” (në specifikimet e dhëna BT-3=386);

j) nëse një person i tatueshëm, që vepron si blerësi ose klienti, është përgjegjës për pagimin e TVSH-së, fatura përmban tekstin: ‘Auto ngarkesë’ (në specifikimet të dhënat BT-95=AE, BT-102, BT-118 dhe BT-151);

k) në rast të aplikimit të një skeme të veçantë për agjencitë e udhëtimit, fatura duhet të përmbajë tekstin: ‘Skema e Marzhit - Agjentët e udhëtimit’ (në specifikimet të dhënat BT-95=E, BT-102, BT-118, BT-120 që përmbajnë tekstin “Skema e marzhit – Agjentët e udhëtimit”, përdorimi i mundshëm i BT-121 që përmban vlera nga lista e arsyeve të përjashtimit të TVSH-së së CEF (VATEX) dhe BT-151);

l) në rast të një prej organizimeve të posaçme të zbatueshme për mallrat e përdorura, veprat e artit, artikujt e koleksionistëve dhe antike, aplikimi i faturës përmban deklaratën: “Skema e marzhit - mallra të përdorura”; “Skema e marzhit – Veprat e artit” ose “Skema e marzhit – Artikujt e koleksioneve dhe antikët” përkatësisht (në specifikimet të dhënat BT-95=E, BT-102, BT-118, BT-120 që përmbajnë tekstin “Skema e marzhit – Agjentët e udhëtimit”, përdorimi i mundshëm i BT-121 që përmban vlera nga lista e arsyeve të përjashtimit të TVSH-së së CEF (VATEX) dhe BT-151);

m) nëse tatimpaguesi është një person që zbaton skemën e marzhit, fatura përmban tekstin: “Shitje që i nënshtrohet skemës së marzhit të fitimit” (në specifikimet e dhëna BG-1);

n) nëse tatimpaguesi është organizator i shitjes me ankand, fatura përmban tekstin: “Shitje që i nënshtrohet skemës së ankandit” për çdo faturë të lëshuar blerësit në lidhje me shitjen me ankand (në specifikimet e dhëna BG-1). Kjo faturë do të ketë gjithashtu informacionin e mëposhtëm:

a. çmimin e shitjes në ankand të mallrave (në specifikimet e dhëna BG-1);
b. taksat dhe detyrimet, detyrimet doganore, tarifrat dhe pagesa të tjera të ngjashme (në specifikimet të dhënat BG-21 dhe BG-23);
c. shpenzime të rastësishme, siç janë: komisioni, paketimi, transporti dhe kostot e sigurimeve, të ngarkuara nga organizatori për blerësin e mallrave (në specifikimet të dhënat BG-23 dhe BG-25);

o) në rastin kur “e drejta” deklarohet “Borxh i keq” sipas legjislacionit në fuqi për TVSH-në, një faturë e re lëshohet me tekstin: “Borxhi i keq” dhe, gjithashtu, duhet të përmbajë referencë për NIVF të faturës fillestare me të cilën lidhet (në specifikimet e dhëna BG-1);

p) në rast se bëhet pagesa për faturën që ka tekstin “Borxh i keq” sipas legjislacionit në fuqi për TVSH-në, duhet të lëshohet një faturë e re që duhet të përmbajë tekstin: “Borxhi i keq i paguar” dhe referencë për NIVF-në e faturës së lëshuar më parë me tekstin “Borxhi i keq” (në specifikimet e dhëna BG-1);

q) për të gjithë paguesit e TVSH-së, të përmendur në nenin 153, të ligjit nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar”, fatura duhet të përmbajë tekstin: “TVSH-ja aplikohet në zbatim të nenit 153, të ligjit nr. 92/2014 ‘Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar’” (në specifikimet e dhëna BT-120 ose BG-1).

3. Përveç elementeve të përmendura në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, fatura elektronike, nëse aplikohet, gjithashtu, duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme:

a) informacion mbi marrësin e pagesës (në specifikimet e dhëna BG-10);
b) informacion për përfaqësuesin tatimor (në specifikimet e dhëna BG-11);
c) referencën e kontratës (në specifikimet e dhëna BT-12);
d) detajet e transportit, siç janë: emri, adresa dhe NIPT ose NID i transportuesit, targa e automjetit dhe koha e furnizimit (në specifikimet të dhënat BG-13, BG-15 dhe BG-1);

e) datën ose periudhën në të cilën është kryer furnizimi i mallrave ose shërbimeve, ose datën në të cilën është bërë pagesa në llogari, e përmendur në pikën 1, të nenit 7, të ligjit, për aq kohë sa mund të përcaktohet kjo datë dhe nëse kjo datë është e ndryshme nga data e lëshimit të faturës (në specifikimet të dhënat BT-72 dhe BG-14);

f) shtesa ose zbritje të aplikuar (informacion mbi kompensimin ose pagesën), nëse është e aplikueshme (në specifikimet të dhënat BG-20, BG-21, BG-27 dhe BG-28);

g) afatet e pagesës, në rast se pagesa nuk është bërë në kohën e faturimit (në specifikimet e dhëna BT-9);

h) kur fatura lëshohet nga blerësi në lidhje me furnizimin e marrë nga furnizuesi, fatura duhet të përmbajë tekstin “Vetëfaturim” (në specifikimet e dhëna BG-1).

4. Elementi i përmendur në nenin 9 të ligjit, në lidhje me Kodin QR, nuk është pjesë përbërëse e formës elektronike të strukturuar për faturën elektronike, por është zhvilluar posaçërisht (si shtojcë).

5. Përveç elementeve të përmendura në këtë nen, fatura elektronike, në varësi të marrëdhënieve të biznesit në të cilën fatura lëshohet dhe shkëmbehet duhet, gjithashtu, të përmbajë elemente që varen nga ato marrëdhënie biznesi, të cilat specifikohen dhe shpjegohen në Dokumentin për Specifikimet Bazë të Përdorimit të Faturave, sipas pikës 6 të këtij neni.

6. Elementet e faturës elektronike të cilave iu referohet ky nen janë shtjelluar dhe shpjeguar në Dokumentin për Specifikimet Bazë të Përdorimit të Faturave, të publikuar në faqen zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Neni 5

Modeli semantik i të dhënave

1. Modeli semantik i të dhënave dhe kuptimi i tyre është një grup termash i strukturuar dhe i ndërlidhur logjikisht, që përcakton elementet thelbësore të një faturë elektronike. Modeli semantik i të dhënave është marrë nga standardet shqiptare, të cilat janë adaptime të pjesës së 1-rë të Standardit Evropian, modeli i të dhënave semantike i elementeve thelbësore të një fature elektronike dhe lista e sintaksës sipas DS/CEN / TS 16931-2: 2017.

2. Elementet bazë të një fature elektronike janë elemente të informacionit thelbësor që një faturë elektronike duhet të përmbajë në mënyrë që të mundësojë ndërveprimin ndërkufitar, përfshirë informacionin e nevojshëm për faturat elektronike për të siguruar pajtueshmërinë ligjore.

Neni 6 **Sintaksa**

Sintaksa është gjuhë ose dialekt i lexueshëm nga makina që përdoret për të përfaqësuar elementët e informacionit që përmban një faturë elektronike. Lista e sintaksave është marrë nga standardet shqiptare të cilat janë adaptime të pjesës së 2-të e standardit evropian, lista e sintaksave që përputhen DS dhe me EN 16931-1. Rregullat sintaksore janë udhëzime se si një model semantik i të dhënave për një faturë elektronike mund të përfaqësohet në sintaksa të ndryshme.

Neni 7 **Modeli bazë i faturës elektronike**

Modeli bazë i faturës elektronike duhet të përmbajë një model semantik të të dhënave për elementet bazë të një fature elektronike të përmendur në nenin 5 të këtij udhëzimi, i cili është shtjelluar imtësisht në Dokumentin për Specifikimet Bazë të Përdorimit të Faturave, të publikuar në faqen zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Neni 8 **Specifikimi i përdorimit të modelit bazë të faturës elektronike**

Specifikimi i përdorimit të modelit bazë të faturës elektronike është dokumenti që përmban udhëzime të hollësishme, shpjegime dhe shembuj, si dhe rregulla specifike të punës që lëshuesi i faturës elektronike është i detyruar të përmbushë në rastin e lëshimit të faturës elektronike. Specifikimi i përdorimit të modelit bazë të faturës elektronike përbën një shtesë dhe duhet të jetë në përputhje me standardet shqiptare të cilat janë adaptime me standardet evropiane dhe të njohura në mënyrë unike dhe të shtjelluara në Dokumentin për Specifikimet Bazë të Përdorimit të Faturave të publikuar në faqen zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Neni 9 **Metoda për të siguruar autenticitetin e origjinës, integritetin e përmbajtjes dhe lexueshmërinë e faturave elektronike**

1. Lëshuesi i faturës elektronike është i detyruar të përmbushë detyrimin e përmendur në nenin 2, pika 2, e këtij udhëzimi. Lëshuesi e marrësi i faturës elektronike janë të detyruar të përmbushin detyrimin e përmendur në nenin 2, pika 3, e këtij udhëzimi me nënshkrimin elektronik dhe certifikatën elektronike që i referohen nenit 19 të ligjit.

2. Autenticiteti i origjinës nënkupton sigurimin e identitetit të lëshuesit të faturës elektronike. Lëshuesi i faturës elektronike duhet të jetë në gjendje të konfirmojë se ai ka lëshuar faktikisht faturën elektronike ose që fatura është lëshuar në emër të tij dhe marrësi i faturës elektronike duhet të konfirmojë që fatura elektronike është marrë nga lëshuesi i faturës elektronike.

3. Integriteti i përmbajtjes do të thotë që përmbajtja të jetë në përputhje me ligjin dhe këtë udhëzim, si dhe nuk është e ndryshueshme nga momenti i lëshimit deri në përfundimin e periudhës së ruajtjes së faturës elektronike. Me kushtin që përmbajtja e faturës nuk është e modifikueshme, formati i strukturuar i përmbajtjes mund të shndërrohet në formate të tjera.

4. Lexueshmëria e një fature elektronike do të thotë që fatura elektronike mund të lexohet nga momenti i lëshimit deri në fund të periudhës së ruajtjes së saj. Kjo gjendje do të konsiderohet e përmbushur nëse fatura, sipas kërkesës, mund të paraqitet brenda një kohe të arsyeshme dhe pa vonesë dhe pas procesit të konvertimit të formatit të strukturuar të përmbajtjes në një format të lexueshëm. Një prezantim vizual i lexueshmërisë së një fature elektronike mund të sigurohet përmes një nënshkrimi elektronik që plotëson parakushtin për të vizualizuar një format elektronik të strukturuar dhe të përshtatshëm për leximin nga njeriu. Një nënshkrim elektronik është dëshmi e mjaftueshme e lexueshmërisë. Fatura elektronike duhet të hartohet në atë mënyrë që të gjitha informacionet e paraqitura në faturë të jenë qartësisht të lexueshme.

KREU III

DETYRIMET E LËSHUESVE DHE MARRËSVE TË FATURAVE ELEKTRONIKE

Neni 10

Regjistrimi i lëshuesve dhe marrësve të faturave elektronike në platformën qendrore të faturave për qëllimin e shkëmbimit të faturave elektronike

1. Në mënyrë që të shkëmbejnë faturat elektronike përmes platformës qendrore të faturave, lëshuesi dhe marrësi i faturës elektronike duhet të paraqesin informacion shtesë elektronikisht përmes platformës qendrore të faturave.

2. Lëshuesit dhe marrësit e faturave elektronike që janë regjistruar në regjistrin e Administratës Tatimore në përputhje me nenin 13 të ligjit, si tatimpagues që lëshojnë fatura, caktohen automatikisht në të njëjtin regjistrë si lëshues dhe marrës të faturave elektronike.

3. Lëshuesit dhe marrësit e faturave elektronike të cilëve iu referohet pika 2 e këtij neni dhe marrësit e faturës elektronike të cilëve iu referohet neni 11 i këtij udhëzimi që kanë njësi të ndryshme biznesi me të cilat do të lidhet fatura elektronike, janë të detyruar të paraqesin informacion shtesë mbi këto njësi biznesi në mënyrë elektronike përmes platformës qendrore të faturave brenda 24 orëve para fillimit të lëshimit, marrjes ose shkëmbimit të faturave elektronike përmes kësaj platforme, dhe mbajtjen e të dhënave veçmas për secilën njësi biznesi.

Neni 11

Regjistrimi i marrësve të faturave elektronike

1. Marrësi i faturës elektronike, përveç detyrimeve të përcaktuara në nenin 10 të këtij udhëzimi, duhet të regjistrohet në regjistrin e Administratës Tatimore përmes platformës qendrore të faturave si marrës i faturave elektronike brenda 24 orëve para fillimit të marrjes së faturave elektronike përmes kësaj platforme, në mënyrë që të marrë një faturë elektronike përmes platformës qendrore të faturave.

2. Marrësi i faturave elektronike, sipas pikës 1 të këtij neni, është i detyruar të marrë një certifikatë elektronike, në përputhje me nenin 19 të ligjit, për të pasur mundësi që të përdorë platformën qendrore të faturave, për qëllim të shkëmbimit të faturave elektronike.

Neni 12

Mënyra e caktimit dhe regjistrimit në platformën qendrore të faturave me qëllim të shkëmbimit të faturave elektronike

1. Caktimi në regjistër sipas nenit 10, pika 3 dhe regjistrimi sipas nenit 11 të këtij udhëzimi kryhen automatikisht përmes shërbimit të web-it SOAP ose aplikacionit të portalit.

2. Lëshuesit dhe marrësit e faturave elektronike janë të detyruar të paraqesin çdo ndryshim të dhënave përmes shërbimit të web-it SOAP ose aplikacionit të portalit.

3. Mënyra e caktimit, regjistrimit dhe paraqitjes së të dhënave për ndryshimet, si dhe të dhënat që duhet të dorëzohen, përshkruhen dhe kryhen në përputhje me Specifikimet Teknike të Shkëmbimit të të Dhënave të publikuara në faqen zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

KREU IV

PROCEDURA PËR LËSHIMIN DHE SHKËMBIMIN E FATURAVE ELEKTRONIKE DHE DOKUMENTEVE SHOQËRUESE

Neni 13

Fiskalizimi si kërkesë paraprake për lëshimin e një fature elektronike

1. Procedura e fiskalizimit të faturave dhe procedura e thjeshtuar e fiskalizimit, të cilat kryhen në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, paraprin dhe është një kërkesë që duhet të përmbushet para shkëmbimit të një fature elektronike.

2. Para lëshimit të një fature elektronike, lëshuesi është i detyruar të përmbushë kërkesën e përmendur në pikën 1 të këtij neni.

3. Marrësi i një fature elektronike mund të marrë vetëm një faturë elektronike që plotëson kërkesën e pikës 1 të këtij neni.

4. Certifikata elektronike e përdorur për zbatimin e procedurës së fiskalizimit të faturës, gjithashtu mund të përdoret për t'u lidhur dhe komunikuar me platformën qendrore të faturave për mjedisin e punës, si dhe për caktimin dhe regjistrimin të cilit i referohet neni 12 i këtij udhëzimi.

Neni 14

Validimi i faturës elektronike

Lëshuesi i faturës elektronike mundet që, përpara procesit të fiskalizimit, të përmendur në nenin 13 të këtij udhëzimi, të kryejë procedurën elektronike të validimit të faturës, në përputhje me Specifikimet Teknike të Shkëmbimit të të Dhënave të publikuara në faqen zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Neni 15

Lëshimi i faturës elektronike

1. Lëshuesi i faturës elektronike është i detyruar të lëshojë faturën elektronike dhe marrësi është i detyruar të marrë faturën elektronike në një formë të strukturuar elektronike, në përputhje me standardin evropian dhe dispozitat e ligjit dhe këtij udhëzimi.

2. Nëse lëshuesi i një fature elektronike lëshon një faturë me elementë shtesë karakteristike për sektorin e caktuar të biznesit (për shembull, sektori i ndërtimeve), në formën e një dokumenti i cili nuk mund të shoqërojë formën e strukturuar elektronike në përputhje me standardin evropian dhe dispozitat e ligjit dhe këtij udhëzimi, është i detyruar të dërgojë një dokument të tillë në përputhje me rregullat për dokumentet shoqëruese të përmendura në nenin 18, të këtij udhëzimi.

3. Në rastin e përmendur në pikën 2 të këtij neni, lëshuesi i faturës elektronike nuk përjashtohet nga detyrimi për të lëshuar dhe dërguar një faturë elektronike në një formë elektronike të strukturuar, në përputhje me Standardin Evropian dhe dispozitat e ligjit dhe këtij udhëzimi, bazuar në të dhënat e përfshira në dokument.

Neni 16

Shkëmbimi i faturave elektronike

1. Lëshuesi i faturës elektronike është i detyruar të dërgojë faturën elektronike dhe marrësi i faturës elektronike është i detyruar të marrë faturën elektronike përmes platformës qendrore të faturave.

2. AKSHI shkëmben faturën elektronike nga lëshuesi tek marrësi i faturës elektronike përmes platformës qendrore të faturave.

3. Marrësi i një fature elektronike është i detyruar të sigurojë që fatura elektronike të merret nga platforma qendrore e faturave, në mënyrën e rregulluar në Specifikimin Teknik të Shkëmbimit të të Dhënave të publikuar në faqen zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Neni 17

Statusi i faturës elektronike

1. Statusi i faturës elektronike është një mesazh që marrësi i faturës elektronike përmes platformës qendrore të faturave mund t'i dërgojë lëshuesit të faturës elektronike.

2. Nëpërmjet platformës qendrore të faturave mund të dërgohen statuset e mëposhtme:

a) pranuar për t'u paguar – marrësi i faturës elektronike ka kontrolluar faturën dhe e ka aprovuar atë për pagesë;

b) refuzuar – marrësi i faturës elektronike e kundërshton faturën;

c) paguar – marrësi i faturës elektronike ka paguar faturën plotësisht;

d) paguar pjesërisht – marrësi i faturës elektronike ka paguar pjesërisht faturën.

3. Marrësi dhe lëshuesi i faturës elektronike, përmes platformës qendrore të faturave, mund të dërgojnë dhe marrin mesazhet sipas pikës 2 të këtij neni.

Neni 18

Lëshimi dhe shkëmbimi i dokumenteve shoqëruese

1. Dokumentet shoqëruese lëshohen dhe shkëmben si pjesë e strukturës elektronike të faturës, në përputhje me nenet 15 dhe 16, të këtij udhëzimi.

2. Nëse dokumentet shoqëruese për arsye juridike ose reale mund të mos jenë pjesë e strukturës së faturës elektronike, lëshuesi i faturës elektronike është i detyruar të sigurojë një referencë në faturën elektronike të dokumenteve shoqëruese dhe t'i dërgojë ato me postë ose në një mënyrë tjetër të dakordësuar reciprokisht.

3. Përmasa e faturës elektronike dhe dokumenteve shoqëruese, formati i skedarit të dokumenteve shoqëruese dhe përmbajtja e referencës të përmendur në pikën 2 të këtij neni rregullohen në Dokumentin për Specifikimet Bazë të Përdorimit të Faturave të publikuar në faqen zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

KREU V

MESAZHET PËR MARRJEN E FATURËS ELEKTRONIKE

Neni 19

Mesazhi i marrjes dhe koha e dërgimit të faturës elektronike në platformën qendrore të faturave

1. AKSHI njofton lëshuesin e faturës elektronike se fatura elektronike është marrë (pranuar) në platformën qendrore të faturave.

2. Mesazhi sipas pikës 1 të këtij neni përmban të dhëna për kohën (orën, minutën dhe sekondën) që konsiderohet të jetë koha e dërgimit të faturës elektronike nga lëshuesi i faturës elektronike.

Neni 20

Mesazhi i marrjes dhe koha e marrjes së faturës elektronike nga marrësi

1. Marrësit e faturave elektronike janë të detyruar që, pa vonesë, të marrin faturën elektronike nga platforma qendrore e faturave dhe t'i dërgojnë AKSHI-t përmes platformës qendrore të faturave një mesazh që ai ka marrë faturën elektronike dhe dokumentet shoqëruese.

Detyrimi për marrjen e faturës elektronike mund të përmbushet përmes zgjidhjeve të ndryshme teknike të përshkruara në Specifikimin Teknik të Shkëmbimit të të Dhënave të publikuar në faqen zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. "Pa vonesë" do të thotë se, në varësi të zgjidhjes teknike të përdorur, marrësi është i detyruar të përmbushë detyrimin e tij sa më shpejt të jetë e mundur, pa vonesë, duke marrë parasysh rrethanat e deklaruara më parë.

2. AKSHI nuk është i detyruar që t'i dërgojë lëshuesit të faturës elektronike një mesazh për marrjen e faturës elektronike dhe dokumenteve shoqëruese të përmendura në pikën 1 të këtij neni, por mund të dërgojë mesazhin me kërkesën e lëshuesit.

3. Mesazhi nga pika 1 e këtij neni përmban të dhëna për kohën (orën, minutën dhe sekondën) që konsiderohet se është koha e marrjes së faturës elektronike nga marrësi i faturës elektronike.

Neni 21

Koha e dërgimit dhe e marrjes së faturës elektronike

1. Në rastet kur kërkohet konfirmimi i dërgimit të faturës elektronike dhe dokumenteve shoqëruese, koha e dërgimit të faturës elektronike do të konsiderohet koha e specifikuar në mesazhin e përmendur në nenin 19 të këtij udhëzimi të dërguara nga AKSHI për lëshuesin e faturës elektronike.

2. Në rastet kur kërkohet konfirmimi i marrjes së faturës elektronike dhe dokumenteve shoqëruese, koha e marrjes së faturës elektronike do të konsiderohet koha e specifikuar në mesazhin e përmendur në nenin 20 të këtij udhëzimi, dërguar nga marrësi i faturës elektronike tek AKSHI përmes platformës qendrore e faturave.

Neni 22

Mesazhi

Forma dhe mënyra e mesazheve të përmendura në nenet 17, 19 dhe 20 të këtij udhëzimi duhet të jenë në përputhje me rregullat e rregulluara në Specifikimin Teknik të Shkëmbimit të të Dhënave të publikuar në faqen zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

KREU VI

PAMUNDËSIA E LËSHIMIT DHE SHKËMBIMIT TË FATURAVE ELEKTRONIKE

Neni 23

Pamundësia e lëshimit dhe shkëmbimit të faturave elektronike për shkak të vështirësive teknike

1. Nëse lëshuesi dhe/ose marrësi i faturës elektronike përcaktojnë se ata nuk mund të dërgojnë ose pranojnë faturën elektronike për shkak të vështirësive teknike, ata detyrohen të njoftojnë AKSHI-n, i cili duhet të publikojë njoftimin në faqet e tij zyrtare të internetit.

2. Lëshuesi dhe/ose marrësi i faturës elektronike janë të detyruar, brenda dy ditëve nga dita në të cilën kanë ndodhur vështirësitë teknike, të korrigjojnë vështirësitë teknike dhe t'i dërgojnë një njoftim AKSHI-t se vështirësia teknike është eliminuar. Në vijim, AKSHI publikon njoftimin në faqet e tij zyrtare të internetit.

3. Lëshuesi dhe/ose marrësi i faturës elektronike janë të detyruar t'ia dërgojnë AKSHI-t njoftimin nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni me postë elektronike.

4. Nëse AKSHI përcakton se nuk mund të shkëmbejë faturën elektronike dhe dokumentet shoqëruese për shkak të vështirësive teknike, është i detyruar të publikojë një njoftim në faqen e tij zyrtare të internetit për pamundësinë e shkëmbimit të faturës elektronike dhe dokumenteve shoqëruese për shkak të vështirësive teknike dhe brenda dy ditësh nga dita kur kanë ndodhur vështirësitë teknike, duhet të korrigjojë vështirësitë teknike dhe publikojë një njoftim se vështirësia teknike është eliminuar.

5. Nëse fatura elektronike pranohet në platformën qendrore të faturave dhe marrësi i faturës elektronike nuk është në gjendje të marrë faturën elektronike nga platforma qendrore e faturave për shkak të vështirësive teknike dhe të dërgojë mesazhin e përmendur në nenin 20 të këtij udhëzimi, detyrohet të dërgojë mesazhin pasi AKSHI të dërgojë njoftim për eliminimin e vështirësive teknike nga pika 2 e këtij neni ose pas njoftimit për eliminimin e vështirësive teknike nga pika 5 e këtij neni nga AKSHI.

6. Në rast të publikimit të njoftimit të përmendur në pikat 1, 2 dhe 5 të këtij neni, lëshuesi i faturës elektronike mund t'i dërgojë marrësit faturën dhe dokumentet shoqëruese në rrugë postare ose në një mënyrë tjetër me marrëveshje reciproke.

KREU VII

DOKUMENTIMI NË TRANSPORTIMIN E MALLRAVE DHE FATURA SHOQËRUESE

Neni 24

Dokumentet e transportit

1. Sipas ligjit, transporti i mallrave duhet të shoqërohet me një nga dokumentet e mëposhtëm:

a) faturë tatimore, e cila shoqëron çdo transport të mallrave nga shitësi tek blerësi ose tek personi i tretë me marrëveshje me blerësin. Fatura do të printohet në letër për transaksione me para në dorë, ose duhet të printohet thjesht kodi QR për transaksione pa para në dorë kur ekziston detyrimi për lëshimin e një fature elektronike. Në rastin kur mallrat i furnizohen blerësit me transport, fatura përveç elementeve të detyrueshëm të parashikuar në nenet 9 ose 10, të ligjit dhe legjislacionit në fuqi për tatimin mbi vlerën e shtuar, përfshin gjithashtu:

i. emrin, adresën dhe NIPT-in e transportuesit nëse transportuesi është person fizik ose juridik;

ii. targën e automjetit të transportit;

iii. datë e furnizimit;

iv. adresën e destinacionit të mallrave;

b) faturë shoqëruese e cila shoqëron transportin e mallrave nga një vend në tjetrin në territorin e Republikës së Shqipërisë, kur nuk ka ndryshim të pronësisë mbi mallrat e transportuara.

2. Dokumentet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni lëshohen para ose në momentin kur fillon transportimi i mallrave dhe fiskalizohen në momentin e lëshimit, në kohë reale.

3. Në rastet kur transportimi i mallrave kryhet nga palë të treta (transportuesi), lëvizja e mallrave shoqërohet me faturën tatimore të shitjes së mallrave, e cila gjithashtu përmban transportuesin dhe datën e transportit sipas pikës 1, shkronja "a", e këtij neni. Transportuesi, gjatë transportimit, mban kopjen e parë të faturës, e cila i dorëzohet blerësit ose thjesht dokumentin me kodin QR dhe të dhëna shtesë, sipas pikës 1, shkronja "a", e këtij neni, në rast të faturës elektronike. Kopja e dytë e faturës origjinale, pra kodi QR i printuar dhe të dhëna shtesë, mbahet nga transportuesi. Fatura e shërbimit të transportit (lëshuar nga transportuesi) jo

domosdoshmërisht duhet të shoqërojë lëvizjen e mallrave gjatë transportit. Fatura e shërbimit të transportit duhet të përmbajë të dhëna referuese për faturat e shitjeve për të cilat kryhet dhe faturohet shërbimi i transportit.

4. Në rastin kur tatimpaguesi që lëshon fatura (shitësi) i furnizon (shet) mallrat një tatimpaguesi tjetër (blerësi), por mallrat nuk transportohen nga shitësi te blerësi dhe përkundrazi transportohen në palën e tretë (blerësi i dytë) sipas kontratës së shitjes ose porosisë së blerjes së tatimpaguesit (shitësi), atëherë procedura është si më poshtë:

Tatimpaguesi që lëshon fatura (shitësi) përpara se mallrat të transportohen në destinacionin e palës së tretë (blerësi i dytë), lëshon faturën me informacionin mbi blerësin (rishitësin), informacionin e përcaktuar në pikën 1, shkronja “a”, e këtij neni dhe me të dhëna shtesë mbi informacionin e marrësit (blerësi i dytë) si NIPT-in dhe emri/emri dhe mbiemri i tij. Në rast se lëshohet një faturë elektronike, këto të dhëna shtesë do të printohen së bashku me kodin QR të faturës elektronike. Fatura e shtypur në letër (pra, kodi QR i faturës dhe të dhënat shtesë të printuara në rast të faturës elektronike) duhet të shoqërojnë mallrat gjatë transportit dhe printohet në dy kopje, njëra prej të cilave i përket shitësit, dhe tjetra i jepet transportuesit dhe i paraqitet personave të autorizuar për qëllime kontrolli.

Rishitësi lëshon një faturë menjëherë pas shitësit dhe ia jep palës së tretë (blerësit të dytë), konsumatorit përfundimtar, i cili është edhe marrësi i mallit ose personit për të cilin është i destinuar malli. Në çdo rast, transaksionet e kryera në këtë mënyrë janë të dokumentuara me kontrata të përshtatshme që tregojnë qartë se kush është shitësi, blerësi dhe marrësi i mallit.

Kjo procedurë vlen vetëm kur destinacioni i mallrave është caktuar për tatimpaguesin që është palë e tretë që është marrësi i mallit dhe është i ndryshëm nga tatimpaguesi blerës (rishitësi) të cilit shitësi i ka lëshuar faturën, pavarësisht se kush është personi që kryen transportin. Transportuesi mund të jetë shitësi, rishitësi, blerësi ose një palë e tretë.

Shembull.

Kompania A me adresë në Tiranë ka një kontratë të shitjes së mallrave me Kompaninë B me adresë në Fier, e cila do të paguajë me para në dorë. Në marrëveshjen e blerjes, kompanitë ranë dakord që Kompania A të lëshonte një faturë me TVSH për kompaninë B me adresë në Fier, por ndërkohë mallrat do të transportobeshin në Kompaninë C me adresë në Pogradec. Transportuesi i mallrave është agjensia D, e kontraktuar nga kompania B për dërgimin e mallrave nga Kompania A në Tiranë te Kompania C në Pogradec.

Menjëherë para se mallrat të merren nga magazina për transportim, Kompania A lëshon një faturë për Kompaninë B dhe kopjen tjetër ia jep transportuesit, Kompanisë D, për të shoqëruar transportin e mallrave. Fatura përmban informacione për shitësin - Kompania A, të dhënat e blerësit – Kompania B, të dhënat e marrësit të mallrave – Kompania C, si dhe të dhënat e transportuesit – Kompania D, dhe fiskalizohet para se shitësi - Kompania A, t'ia dorëzojë transportuesit dhe ia dërgon kompanisë B. Kjo faturë printohet kështu në dy kopje, njëra prej të cilave i dërgohet Kompanisë B dhe tjetra i dorëzohet transportuesit. Kompania A dubet të mbajë një kopje të faturës në formë elektronike ose letër.

Nga ana tjetër, Kompania B, e cila në kontratën e saj me kompaninë A merr përgjegjësinë dhe riskun për mallrat e dërguara nga magazina e Kompanisë A, lëshon një faturë për Kompaninë C. Kjo e fundit mban faturën nga Kompania B për qëllime tatimore, për të regjistruar që transaksioni ka përfunduar dhe është dokumentuar.

5. Për mallrat e importuara nga jashtë, të transportuara nga dogana ku mallrat janë zhdoganuar, në magazinën e personit të tatueshëm importues, deklarata doganore e importit e lëshuar nga administrata doganore, e shoqëruar nga fatura e lëshuar nga furnizuesi i huaj i mallrave, shërben si dokument për lëvizjen e mallrave. Në raste furnizimesh të mëdha, ku për lëvizjen e mallit nga dogana në magazinën apo magazinat e personit të tatueshëm importues, kërkohen disa mjete dhe ngarkesa transporti, si dokument për lëvizjen e mallit do të shërbejë një dokument shoqërimi i mallit si fatura e shoqërimit kur mund të lëshohet nga importuesi për çdo mjet transporti dhe për çdo ngarkesë ose një dokument i lëshuar nga agjencia spedicionere ose agjencia doganore për çdo mjet transporti dhe për çdo ngarkesë, së bashku me një foto kopje të deklaratës doganore të importit dhe të faturës së lëshuar nga furnitori i huaj i mallit

6. Lëvizja e mallrave, përkatësisht transporti, shoqërohet me një faturë shoqëruese në rastet e lëvizjes së mallrave ose pajisjeve që janë pjesë e kryerjes së një shërbimi (pra, të cilat përdoren për kryerjen e shërbimit), përveç nëse këto mallra specifikohen në faturën e lëshuar për ofrimin e shërbimeve që shoqërojnë transportimin e këtyre mallrave.

7. Në rast të shitjeve derë më derë, kur ngarkohen mallrat në automjetin e transportit, tatimpaguesi që lëshon fatura lëshon një faturë shoqëruese që do të shoqërojë transportin dhe në momentin e shitjes së mallit në terren nga automjeti i transportit, tatimpaguesi lëshon një faturë, e fiskalizon atë me një pajisje elektronike të faturimit të lëvizshme, e printon dhe ia jep konsumatorit së bashku me mallrat e furnizuara.

8. Data e lëshimit të faturës duhet të përputhet me datën e nisjes së transportit. Kur këto data nuk përputhen, pra kur mallrat dërgohen pas datës së lëshimit të faturës, ky fakt nuk përbën një arsye për të bllokuar ose konfiskuar mallrat dhe transportimi i mallrave nuk pengohet. Kur gjykohet e arsyeshme mund të bëhen verifikime të shitësi dhe/ose blerësi, ose të informohen drejtoritë rajonale të juridiksionit, të cilat e përdorin informacionin për verifikime apo kontrolle të mëvonshme.

Neni 25

Detyrimi për të lëshuar fatura shoqëruese

1. Tatimpaguesit që janë të detyruar të lëshojnë fatura, kur transportojnë mallra nga një njësi biznesi në tjetrën në territorin e Republikës së Shqipërisë pa ndryshuar pronësinë mbi mallrat e transportuara, me qëllim monitorimin e lëvizjes së mallrave në territorin e Republikës e Shqipërisë, janë të detyruar të lëshojnë faturë shoqëruese, sipas nenit 39 të ligjit.

2. Fatura shoqëruese lëshohet dhe fiskalizohet para transportit të mallrave, në rastin kur nuk ka transferim të pronësisë, pra, për çdo lëvizje të mallrave nga magazina në magazinë, nga magazina në dyqan ose anasjelltas, nga vendi kryesor i biznesit në një degë, nga vendi i prodhimit në magazinë, nga vendi i prodhimit në dyqan.

3. Detyrimet e tatimpaguesve që lëshojnë fatura shoqëruese janë si më poshtë:

a) të marrin një certifikatë elektronike nga AKSHI për nënshkrimin elektronik të elementeve të faturës shoqëruese dhe për identifikimin e tyre;

b) të regjistrojnë vendet e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit të tyre (për shembull magazinat) nga të cilat mallrat po merren për transport, në mënyrë elektronike përmes platformës qendrore të faturave, jo më vonë se 24 orë para fillimit të lëshimit të faturave shoqëruese në secilin vend të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit. Në rastin kur nuk ka lidhje internet, ky informacion dorëzohet me rrugë postare në Drejtorinë Rajonale Tatimore me anë të formularit “Informacion mbi vendet e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit”, sipas shtojcës 1, të udhëzimit nr. 16, datë 3.4.2020 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, jo më vonë se 24 orë para fillimit të lëshimit të faturave shoqëruese;

c) të regjistrojnë informacionin mbi operatorin që lëshon fatura shoqëruese në mënyrë elektronike përmes platformës qendrore të faturave, jo më vonë se 24 orë para fillimit të lëshimit të faturave shoqëruese nga secili operator. Në rastin kur nuk ka lidhje interneti, ky informacion dorëzohet me rrugë postare në Drejtorinë Rajonale Tatimore me anë të formularit “Informacion për operatorët” sipas shtojcës 2 të udhëzimit nr. 16, datë 3.4.2020 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, jo më vonë se 24 orë para se operatori të fillojë të lëshojë fatura shoqëruese. I njëjti operator mund të lëshojë fatura shoqëruese dhe fatura, si dhe nëse operatori është regjistruar në sistemin e informacionit të administratës tatimore si operator me qëllim të lëshimit të faturave, nuk duhet të regjistrohet përsëri me qëllim të lëshimit të faturave shoqëruese;

d) të përdorin një pajisje elektronike me një zgjidhje *software*-ike të përfshirë (ose të përdorin ndonjë pajisje elektronike dhe të instalojnë zgjidhjen *software*-ike në formën e një aplikacioni të veçantë ose të përdorin një aplikacion Cloud) për krijimin e faturave shoqëruese me të gjithë elementët e nevojshëm, nënshkrimin elektronik, shkëmbimin elektronik të të dhënave me

administratën tatimore përmes lidhjes në internet dhe marrjes së mesazhit konfirmues nga administrata tatimore, pas verifikimit automatik të secilës faturë shoqëruese, dhe për ruajtjen e të dhënave në formën elektronike të të gjitha faturave shoqëruese të lëshuara;

e) të regjistrojnë informacionin për mirëmbajtësin e *software*-it, bazuar në mënyrën e përshkruar për vendet e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit, sipas shkronjës “b”, të kësaj pike;

f) të lëshojnë fatura shoqëruese për transportin e mallrave me të gjithë elementet e parashikuara në bazë të ligjit dhe nenit 26 të këtij udhëzimi;

g) në rast të defektit të pajisjes elektronike që përdoret për lëshimin e faturave shoqëruese, të përdorin një bllok të veçantë të faturave shoqëruese, të cilin mund të marrin në zyrat rajonale të administratës tatimore, në mënyrë që të lëshojnë fatura shoqëruese nga ky bllok i veçantë derisa pajisja të jetë riparuar ose zëvendësuar me një të re (brenda 5 ditëve nga dita kur pajisjet fiskale kanë pësuar një dëmtim të plotë);

h) të sigurojnë lidhje interneti për shkëmbimin elektronik të të dhënave me administratën tatimore, përveç në zonën ku nuk ka lidhje interneti;

i) të kryejnë procedurën e fiskalizimit të faturave shoqëruese të lëshuara;

j) të gjenerojnë dhe printojnë kodin QR me të gjitha elementet e përcaktuara.

Neni 26

Elementet e detyrueshëm të faturës shoqëruese

1. Fatura shoqëruese (FSH) e lëshuar përmban informacionin e parashikuar në nenin 40 të ligjit, si më poshtë:


Elementet e FSH-së	PËRSHKRIMI
I. TITULLI	
Lloji i transaksionit	Të dhëna të mundshme: 1. transferim i mallrave; 2. shitje derë më derë.
Data e lëshimit	Data, ora dhe minuta kur është krijuar FSH
Kodi i operatorit	Kod alfanumerik i gjeneruar nga administrata tatimore
Kodi i vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit	Kodi i vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit nga ku po dërgohen mallrat si një kod alfanumerik i gjeneruar nga administrata tatimore.
Numri i FSH-së	Numri sekuencial, që do të përcaktohet për secilin vend të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit nga ku merren mallrat për transport.
II. INFORMACIONI MBI PRONARIN E MALLRAVE	
NIPT	NIPT-i i tatimpaguesit
Emri i tatimpaguesit	Emri / emri dhe mbiemri i tatimpaguesit
Adresa e tatimpaguesit	Adresa e tatimpaguesit (rruga, qyteti)
III. INFORMACIONI MBI MJETIN E TRANSPORTIT	
Pronësia e mjetit	Të dhëna të mundshme: 1. mjet në pronësi; 2. mjet i një pale të tretë. Nëse zgjidhet “Mjet i një pale të tretë”, duhet të vendoset informacioni për kompaninë transportuese (në fushën IV).

Targa e automjetit	Targa e automjetit
IV. INFORMACIONI PËR KOMPANINË/TRANSPORTUESIN (nëse transportuesi nuk është tatimpaguesi që lëshon FSH-ja)	
NIPT	NIPT-i i tatimpaguesit
Emri i tatimpaguesit	Emri / emri dhe mbiemri i tatimpaguesit
Adresa e tatimpaguesit	Adresa e tatimpaguesit (rruga, qyteti)
V. DETAJET E NISJES	
Qyteti	Qyteti ku janë mallrat dhe nga ku merren për transport
Adresa e rrugës	Adresa e rrugës ku janë mallrat dhe nga ku merren për transport
Data dhe koha e nisjes	Data dhe koha e nisjes: ora dhe minuta
Lloji i pikës së nisjes	Të dhëna të mundshme: 1. magazinë, 2. ekspozitë, 3. dyqan, 4. pikë shitjeje, 5. magazinë e një personi tjetër, 6. magazinë doganore, 7. tjetër.
VI. DETAJET E DESTINACIONIT	
Qyteti	Qyteti ku dërgohen mallrat
Adresa e rrugës	Adresa e rrugës ku dërgohen mallrat
Data e pritshme e mbërritjes	Data e pritshme kur mallrat duhet të mbërrijnë në destinacionin e tyre
Lloji i pikës së mbërritjes	Të dhëna të mundshme: 1. magazinë, 2. ekspozitë, 3. dyqan, 4. pikë shitjeje, 5. tjetër.
VII. INFORMACIONI PËR MALLRAT	
A janë të ndezshme	Të dhëna të mundshme: 1. po 2. jo
Kërkohej shoqërim (eskortë) gjatë transportit	Të dhëna të mundshme: 1. po 2. jo
PAKETIMI (mundësi të disa shënimeve; nëse mallrat transportohen në pako)	
Lloji i paketimit	Fushë tekst
Numri i pakove	Fushë numerike
Numri i artikujve të mallrave	Numri i artikujve të mallrave
INFORMACIONI PËR ÇDO ARTIKULL TË TRANSPORTUAR	
Kodi i mallrave	Kodi i artikullit, nëse aplikohet
Përshkrimi i artikujve	Përshkrimi i artikujve, pra emri i saktë i mallit
Njësia e matjes	Njësia matëse e mallrave

Sasia	Sasia e mallrave
Vlera	Vlera e mallrave me çmim kostoje
VIII. IDENTIFIKUESIT UNIKË	
NIVFSH	Numri Identifikues i Veçantë i Faturës Shoqëruese (NIVFSH), i shprehur si një kod alfanumerik, i gjeneruar nga sistemi i informacionit i administratës tatimore.
NSLFSH	Numri i Sigurisë së Lëshuesit të Faturës Shoqëruese (NSLFSH), i shprehur si një kod alfanumerik, i gjeneruar nga sistemi i informacionit të tatimpaguesit para fiskalizimit.

2. Të dhënat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni janë elementë të detyrueshëm të faturës shoqëruese dhe dërgohen në format XML në sistemin e informacionit të administratës tatimore në momentin e lëshimit (përveç NIVFSH). Pasi sistemi i informacionit i administratës tatimore verifikon mesazhin e marrë dhe nëse verifikimi është i suksesshëm gjeneron NIVFSH dhe e dërgon atë në një mesazh përgjigjeje tek tatimpaguesi përmes të njëjtit kanal komunikimi. Pas kësaj, tatimpaguesi që lëshon faturën shoqëruese, pra, zgjidhja *software*-ike që ai përdor për lëshimin e faturave shoqëruese do të gjenerojë kodin QR dhe operatori do ta printojë atë në letër dhe do t'ia japë transportuesit që duhet ta mbajë atë për të gjithë periudhën e transportit, deri në destinacion.

3. Shembull i dokumentit me kodin QR të printuar që përfaqëson faturën shoqëruese:



4. Administrata tatimore, pas verifikimit të faturës shoqëruese të marrë nga tatimpaguesi, i kthen tatimpaguesit Numrin Identifikues të Veçantë të Faturës Shoqëruese (NIVFSH) si një konfirmim të elementeve të faturës shoqëruese të marra siç duhet, në përputhje me nenin 40 të ligjit dhe pikën 3 të këtij neni. NIVFSH është unik për secilën faturë shoqëruese.

5. Shkurtimi NIVFSH përdoret për identifikuesin unik të faturës shoqëruese dhe llogaritet me metodën UUID (identifikues unik universal).

6. Numri i Sigurisë së Lëshuesit të Faturës Shoqëruese (NSLFSH) është një kod alfanumerik që konfirmon lidhjen midis tatimpaguesit që lëshon faturën shoqëruese dhe faturës shoqëruese.

NSLFSH krijohet nga tatimpaguesi, pra nga zgjidhja *software*-ike që ai përdor për të lëshuar dhe fiskalizuar faturat shoqëruese, kur krijon faturën shoqëruese menjëherë para paraqitjes në një mesazh XML në sistemin e informacionit të administratës tatimore, së bashku me elementët e tjerë të detyrueshëm të faturës shoqëruese.

7. NSLFSH përcaktohet nga informacionet e faturës shoqëruese:

a) që sigurojnë unicitetin e faturës shoqëruese:

i. NIPT-i i tatimpaguesit që lëshon faturën shoqëruese,

ii. data dhe koha e lëshimit të faturës shoqëruese,

iii. numri i faturës shoqëruese,

iv. kodi i vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit,

v. kodi i zgjidhjes *software*-ike të përdorur për lëshimin e faturave shoqëruese.

b) që sigurojnë autenticitetin e tatimpaguesit që lëshon fatura shoqëruese, nënshkrimi elektronik me çelësin privat të certifikatës elektronike, të cilën tatimpaguesi e merr nga AKSHI për qëllime të fiskalizimit.

8. Për të siguruar verifikimin e lehtë të faturës shoqëruese, duhet të gjenerohet një kod QR për të gjitha faturat shoqëruese të lëshuara. Kodi QR është një element i detyrueshëm i faturës shoqëruese, si në rastin kur fatura shoqëruese raportohet me sukses tek Administrata Tatimore dhe fiskalizohet (fatura shoqëruese ka marrë një NIVFSH), dhe në rastet kur fatura shoqëruese nuk mund të fiskalizohet (mungesa e internetit, disponueshmëria e serverit të shërbimit fiskalizues). Kodi QR duhet të printohet në letër dhe shërben si një dokument transporti për mallrat e dërguara. Të dhënat e faturës shoqëruese do të formojnë një URL që përfaqësohet nga kodi QR. Zgjidhja *software*-ike e përdorur për lëshimin e faturave shoqëruese dhe për të realizuar procesin e fiskalizimit, automatikisht duhet të krijojë një URL në formatin e specifikuar në specifikimet teknike të publikuara në faqen zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Neni 27

Zbatimi i procedurës së fiskalizimit të faturave shoqëruese

1. Procedura e fiskalizimit të faturave shoqëruese zbatohet sipas udhëzimit nr. 16, datë 3.4.2020 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”.

2. Në momentin kur lëshohet fatura shoqëruese, para transportit, tatimpaguesi duhet të nënshkruajë në mënyrë elektronike elementët e faturës shoqëruese, pas kësaj t’i dërgojë ato në sistemin e informacionit të administratës tatimore përmes një lidhjeje interneti. Sistemi i informacionit i administratës tatimore, pasi pranon mesazhin e marrë, kontrollon nëse të gjitha pjesët e përcaktuara të faturës shoqëruese janë dorëzuar dhe nëse fatura shoqëruese është nënshkruar me një certifikatë të vlefshme elektronike. Nëse plotësohen të gjitha kushtet, sistemi i informacionit i administratës tatimore përcakton një Numër Identifikues të Veçantë të Faturës Shoqëruese (NIVFSH) dhe përmes lidhjes në internet e dërgon atë tek tatimpaguesi.

3. Në rastet kur nuk plotësohen të gjitha kushtet e përcaktuara dhe administrata tatimore nuk mund të përcaktojë NIVFSH, i dërgon në të njëjtën mënyrë tatimpaguesit mesazhin e gabimit, me përshkrimin e gabimit. Tatimpaguesi është i detyruar të korrigjojë parregullsitë dhe më pas të përsërisë procedurën e fiskalizimit. Gabimet e mundshme janë renditur në specifikimet teknike të publikuara në faqen zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe në udhëzimin nr. 16, datë 3.4.2020 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”.

4. Tatimpaguesi që lëshon fatura shoqëruese mund të shikojë të gjitha faturat shoqëruese të lëshuara në platformën qendrore të faturave në llogarinë e tij të përdoruesit.

KREU VIII DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 28
Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet sipas afateve të parashikuara në ligj.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj

Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 103, datë 04.06.2020